

E DIEL

9 Qershor

2019



Pjetër Arbnori, Lordi Bethel dhe spiuni Kim Philby

Kur Pjetër Arbnori i kërkoi Sotheby's t'i kthehet trashëgimia e spiunit Kim Philby të persekutuarve shqiptarë

NGA NDIK GJINI

Në vitin 1994 Pjetër Arbnori i shkruan një letër njërës prej Lordëve më të shquar të Britanisë së Madhe, Nicholas Bethel. Duke marrë shkas nga kjo letër e Arbnorit, Lordi Bethel më 6 Shtator 1994 botoi një shkrim të gjatë në gazetën Independent, që është gazeta me prestigjioze e Mbretërisë së Bashkuar.

Pjetër Arbnori në rolin e tij si Kryetar i Parlamentit të Shqipërisë i kërkoi Lordit Bethel që të përdorë autoritetin e tij për të bindur drejtuesit e Sotheby's që përfitimet e disa shitjeve me an-

kand që ato po bënin t'u jepeshin disa të persekutuarve politikë në Shqipëri.

Sotheby's është një nder korporatat më të mëdha në botë që shet me ankand sende dhe objekte me vlera historike.

Në Korrik të vitit 1994, vetëm gjashtë vjet pas vdekjes së spiunit të famshëm Kim Philby, korporata me fame botërore për shitjet me ankand të objekteve me vlerë historike, Sotheby's, pasi kishte blerë në Moskë apartamentin dhe të gjitha objektet e spiunit Kim Philby, vendos t'i shesë ato me ankand, dhe paratë e grumbulluara nga këto shitje t'i japë për bamirësi.

Pjetër Arbnori sapo e mëson këtë lajm vendos menjëherë t'i shkruajë një letër mikut të tij Lordit Bethel. Ai, përmes kësaj letrë, i kërkoi Lordit Bethel të ndërhyjë

tek drejtuesit e korporatës Sotheby's që paratë e grumbulluara nga këto shitje të mos u jepën shoqatave bamirëse në Londër por t'u jepën viktimave apo familjareve të viktimave shqiptare që u vranë apo u burgosën si pasojë e spiunimit tek KGB dhe Organet e Sigurimit Shqiptar të këtij dubel agjenti.

Lordi Bethel sapo e merr këtë letër, me përgjegjësinë e një politikani karriere dhe të një historiani dinjitoz ulet dhe shkruan një artikull të gjatë rreth kësaj çështje. Artikulli i Lordit Bethel është i gjatë i detajuar dhe me mjaft informacion të rëndësishëm rreth rolit të Philby-it dhe viktimave shqiptare që ka shkaktuar veprimtaria e tij spiunuese për llogaritë të KGB dhe Organeve të Sigurimit Shqiptar.

→ Vijnë nga faqja 14



Maks Velo dhuron punët e tij kushtuar vëllezërve Ivanaj

Artisti Maks Velo ka dhuruar 7 vepra të realizuara në kohë ndryshme që, sipas tij, u frymëzuan nga personaliteti i Mirash Ivanaj, me jetën e të cilit lidhet vuajtja e përbashkët si një ish i burgosur politik gjatë ditëve të errëta të Shqipërisë. Veprat ndryshojnë në madhësi dhe në llojin e artit, nga skica të vogla me laps mbi letër, tek dy të mëdha të skicuara me qymyr druri dhe bojë vaji...

Në këtë numër: ANA BARTON, ARJAN PETERS PËR FLUTURA AÇKËN, LUAN TOPÇIU PËR VISAR ZHITIN, NDIK GJINI, MAK VLO DHURON PORTRETET E VËLLEZËRVE IVANAJ, ENVER KUSHI ETJ...

D

DOKUMENT

E thënë me pak fjalë: Pjetër Arbnori në rolin e tij si Kryetar i Parlamentit të Shqipërisë i kërkon Lordit Bethel që të përdorë autoritetin e tij për të bindur drejtuesit e Sotheby's që përfitimet e disa shitjeve me ankand që ato po bënin t'u jepeshin disa të persekutuarve politikë në Shqipëri.

Sotheby's është një ndër korporatat më të mëdha në botë që shet me ankand sende dhe objekte me vlera historike.

Pjetër Arbnori, Lordi Bethel dhe spiuni Kim Philby

NGA NDREK GJINI

Në vitin 1994 Pjetër Arbnori i shkruan një letër njërit prej Lordëve më të shquar të Britanisë së Madhe, Nicholas Bethel. Duke marrë shkas nga kjo letër e Arbnorit, Lordi Bethel me 6 Shtator 1994 botoi një shkrim të gjatë në gazetën Independent, që është gazeta me prestigjioze e Mbretërisë së Bashkuar.

PO CILA ISHTË PËRMBAJTJA E KËSAJ LETRE?

E thënë me pak fjalë: Pjetër Arbnori në rolin e tij si Kryetar i Parlamentit të Shqipërisë i kërkon Lordit Bethel që të përdorë autoritetin e tij për të bindur drejtuesit e Sotheby's që përfitimet e disa shitjeve me ankand që ato po bënin t'u jepeshin disa të persekutuarve politikë në Shqipëri.

Sotheby's është një ndër korporatat më të mëdha në botë që shet me ankand sende dhe objekte me vlera historike.

HISTORIA QË E LIDH ARBNORIN ME NJË LORD DHE ME NJË KRYESPIUN

Para se të flasim rreth historisë që i lidh këto tre persona me një-tjetrin e shoh me vend të shpjegoj shkurt se kush ishin ato:

Pjetër Arbnori (18 Janar 1935 - 8 Korrik 2006), ishte një shkrimtar dhe politikan shqiptar. Ai është quajtur "Mandela i Ballkanit", për shkak të kohës së gjatë: plot 28 vjet, që kaloi në burgjet e diktaturës komuniste. Ai ishte bashkëthemelues i degës së Partisë Demokratike në Shkodër. Prej vitit 1991 deri me 2001 ishte deputet në Parlamentin e Shqipërisë dhe prej vitit 1992 deri më vitin 1997 ishte Kryetar i Parlamentit Shqiptar.

Lord Nicholas William Bethell, (19 Korrik 1938-8 Shtator 2007) ka qenë një politikan britanik. Ai ka qenë edhe historian për Europën Qendrore dhe Lindore. Bethell ka qenë anëtar i Dhomës së Lordëve si konservator nga viti 1967 deri 1999. Lord Bethel ka qenë edhe anëtar i Parlamentit European nga viti 1979 deri më 1994 dhe gjithashtu nga viti 1999 deri më 2003. Në mesin e shumë librave që botoi ishte edhe ai me titull "The great betrayal" (Tradhtia e madhe), ku flet për rolin e agjentit Kim Philby.

Kim Philby, (1912-1988) ishte një spiun Sovjetik. Me vitin 1963, qeveria Britanike pranoi se ish-diplomati i saj, Harold Adrian Russell, Kim Philby, kishte vepruar si agjent Sovjetik. Dezertimi i tij në Bashkimin Sovjetik në Janar 1963 ishte një prej momenteve më dramatike të Luftës së Ftohtë. Në kohën kur ishte me detyrë në Washington në fillim të viteve 1950 si ndërmjetës mes shërbimeve sekretë Britanike dhe atyre Ameri-



kane, Philby tradhtoi operacionin sekret të dërgimit të mijëra shqiptarëve të arratisur në vendin e tyre për të përmbytur regjimin komunist të Enver Hoxhës. Philby pasi u përjashtua nga shërbimi i zbulimit Britanik MI6 u arratis në Moskë. Ai vdiq në vitin 1988, në moshën 76 vjeçare. Philby është cilësuar si një prej spiunëve më dinakë të shekullit XX.

RRETHANAT QË E SHTYJNË ARBNORIN T'I SHKRUAJ LORDIT BETHEL

Në Korrik të vitit 1994, vetëm gjashtë vjet pas vdekjes së spiunit të famshëm Kim Philby, korporata me fame botërore për shitjet me ankand të objekteve me vlerë historike, Sotheby's, pasi kishte blerë në Moskë apartamentin dhe të gjitha objektet e spiunit Kim Philby, vendos t'i shesë ato me ankand, dhe paratë e grumbulluara nga këto shitje t'i japë për bamirësi.

Pjetër Arbnori sapo e mëson këtë lajm vendos menjëherë t'i shkruajë një letër mikut të tij Lordit Bethel. Ai, përmes kësaj letrë, i kërkon Lordit Bethel të ndërhyjë tek drejtuesit e korporatës Sotheby's që paratë e grumbulluara nga këto shitje të mos u jepen shoqatave bamirëse në Londër por t'u jepen viktimave apo familjareve të viktimave shqiptare që u vranë apo u burgosën si pasojë e spiunimit tek KGB dhe Organet e Sigurimit Shqiptar të këtij dubel agjenti.

Lordi Bethel sapo e merr këtë letër, me përgjegjësinë e një politikan karriere dhe të një historiani dinjitoz ulet dhe shkruan një artikull të gjatë rreth kësaj çështje. Ai e boton këtë artikull në gazetën Independent, që është gazeta me e madhe e Britanisë. Ne hyrje të artikullit ai i referohet drejtpërdrejt letrës që ka marrë nga kryetari i Parlamentit Shqiptar dhe propozimit të tij se ku duhet të shkojnë paratë e përfituara nga



këto shitje me ankand të objekteve të kryespiunit Kim Philby.

Artikulli i Lordit Bethel është i gjatë i detajuar dhe me mjaft informacion të rëndësishëm rreth rolit të Philby-it dhe viktimave shqiptare që ka shkaktuar veprimtaria e tij spiunuese për llogari të KGB dhe Organeve të Sigurimit



Apeli i Lordit anglez

Ne përmbyllje të artikullit të tij, të botuar plot 25 vjet më parë, i nxitur nga letra që kishte marrë nga kryetari i Parlamentit Shqiptar, Lordi Bethel ndër të tjera shkruan: "Shpërblimet e majme që kishte përfituar Kim Philby nga ana e KGB-se dhe Bashkimit Sovjetik ishin të pa meritura. Kjo pasi ai me veprimtarinë e tij anti-ligjore shkaktoi me qindra viktima e shkatërroi me mijëra jetë shqiptarësh. Dhe, si për ironi të fatit, shkruan Bethel, në këmbim të gjithë kësaj tragjedie atij iu dhuruan 25 vjet jetë e privilegjuar në Moskë dhe shumë dhurata materiale, disa prej të cilave u paraqitën për ankand në Sotheby's në 19 Korrik 1994. Kjo, mendoj, thotë ai, është një temë që do trajtuar me kujdes. Paratë e fituara nga këto objekte të shitura janë fitimet të ardhura nga akte të tradhtisë, veprime të cilat jo vetëm që shkatërruan shumë jetë, por edhe shkelen ligjin Anglez.

Shqiptar.

Ne përmbyllje të artikullit të tij, të botuar plot 25 vjet më parë, i nxitur nga letra që kishte marrë nga kryetari i Parlamentit Shqiptar, Lordi Bethel ndër të tjera shkruan: "Shpërblimet e majme që kishte përfituar Kim Philby nga ana e KGB-se dhe Bashkimit Sovjetik ishin të pa meritura. Kjo pasi ai me veprimtarinë e tij anti-ligjore shkaktoi me qindra viktima e shkatërroi me mijëra jetë shqiptarësh. Dhe, si për ironi të fatit, shkruan Bethel, në këmbim të gjithë kësaj tragjedie atij iu dhuruan 25 vjet jetë e privilegjuar në Moskë dhe shumë dhurata materiale, disa prej të cilave u paraqitën për ankand në Sotheby's në 19 Korrik 1994. Kjo, mendoj, thotë ai, është një temë që do trajtuar me kujdes. Paratë e fituara nga këto objekte të shitura janë fitimet të ardhura nga akte të tradhtisë, veprime të cilat jo vetëm që shkatërruan shumë jetë, por edhe shkelen ligjin Anglez".

Lordi Bethel, në artikullin e tij, thotë se e mbështet plotësisht propozimin e kryetarit të Parlamentit të Shqipërisë; propozim që ai e kishte marrë përmes një letrë që Arbnori i kishte dërguar atij. Ai thotë se sipas mendimit të tij, një akt i vogël shpërblimi do ishte që, 150.000 paundet e përfituara nga këto shitje t'u jepen Muhamet Hoxhës, Selim Dacit, familjes së Adem Gjures dhe të tjerëve që vuajtën nga pasojat e veprimtarisë anti-ligjore të këtij dubel agjenti. Por, mbi të gjitha, shton ai, paratë nuk duhet të shkojnë kurrsesi për familjen Philby. As ata, as Sotheby's nuk duhet të përfitojnë nga shitja e objekteve që janë fituar nga akte të paligjshme të një zyrtari Britanik që tradhtoi interesat e vendit të tij për llogari të KGB-se, Bashkimit Sovjetik dhe Organeve të Sigurimit Komunist Shqiptar.

DH

DHURIMI


NGA BEN ANDONI

Respekti i madh për vëllezërit Mirash dhe Martin Ivanaj e kanë bërë krijuesin, piktorin e njohur dhe publicistin që t'i dhurojë Fondacionit Ivanaj në Tiranë disa punë të tij, kushtuar vëllezërve Ivanaj. Drita Ivanaj, e bija e Martin Ivanaj, themeluesja e fondacionit M&M Ivanaj e ka vlerësuar këtë dhuratë por ka ndarë dhe shumë përshlyetje për punën dhe kontributin e tij, duke apeluar që shoqëria shqiptare ta kultivojë këtë ndjenjë. Maks Velo ka dhuruar 7 vepra të realizuara në kohë ndryshme që, sipas tij, u frymëzuan nga personaliteti i Mirash Ivanaj, me jetën e të cilit lidhet vuajtja e përbashkët si një ish të burgosur politik gjatë ditëve të errëta të Shqipërisë. Veprat ndryshojnë në madhësi dhe në llojin e artit, nga skica të vogla me laps mbi letër, tek dy të mëdha të skicuara me qymyr druri dhe bojë vaji. Të gjitha punët e piktorit të njohur janë realizuar falë disa fotografive që janë shfaqur në vitet e fundit në artikujt e gazetave që ilustronin jetën dhe punën e Mirash Ivanaj për vendin e tij: Shqipërinë.

Punët, që janë realizuar në pastel dhe në vaj, të përmasave të ndryshme janë vendosur tashmë në mjediset e këtij fondacioni dhe përbëjnë një dëshirë të kahershme të autorit në nderim të Mirash Ivanajt. Në fakt, Z. Velo, me angazhimin e tij të përhershëm publik është munduar që të japë mesazhe në të gjitha fushat. Ato rrokin nga apelet publike, por edhe krijimet dhe sidomos shkrimet publicistike për problematike të ndryshme. Në rastin tonë, ai përgatiti një cikël, kushtuar personalitetit të madh Mirash Ivanaj. Një personazh i jashtëzakonshëm, që e ka bërë për vete arkitektin dhe piktorin e njohur, e të cilit i ka kushtuar këtë cikël. Mirash Ivanaj është një figurë shumë dimensionale dhe që me kujdesin e tij u dedikua arsimimit shqiptar dhe reforma e tij synonte të prekte thelbin e strukturës së paditurisë shqiptare. Por, ai nuk u mjaftua me kaq: ai donte të ngrinte një strukturë jetëgjatë që ta rregullonte të gjithën këtë. Me personalitetin e lartë por me shumë nga të gjitha: konceptet e qarta arriti të vendoste themelet e arsimit modern shqiptar. Fati i jetës nuk u tregua dashamirës me të, por për të gjithë njerëzit ai mbetet një nga pikat e referimit për dinjitetin tonë. Kjo është fillesa e veprimit të pabujshëm të piktorit dhe publicistit të njohur. Jeta dhe fati i Mirash Ivanajt përfundoi në mënyrë tragjike, i trajtuar shumë keq nga regjimi në fuqi, të cilit i besoi verberisht, kur besoi se mund të punonte nën të, falë idealizmit të saj. Maks i ka trajtuar me një kujdes, falë atyre imazheve që kanë mbetur, duke përshfaqur dhe nderimin e tij. Nuk e ka braktisur sti-

Maks Velo ka dhuruar 7 vepra të realizuara në kohë ndryshme që, sipas tij, u frymëzuan nga personaliteti i Mirash Ivanaj, me jetën e të cilit lidhet vuajtja e përbashkët si një ish të burgosur politik gjatë ditëve të errëta të Shqipërisë. Veprat ndryshojnë në madhësi dhe në llojin e artit, nga skica të vogla me laps mbi letër, tek dy të mëdha të skicuara me qymyr druri dhe bojë vaji.

Maks Velo dhuron punët e tij kushtuar vëllezërve Ivanaj



lin e tij duke e përshtatur dhe imazhin e mësuesit të njohur për korpusin e tij artistik...

... Mirash Ivanaj haset pak e gjithnjë e shumë pak në literaturën tonë. Falë Fondacionit dhe punës së tij të përshtatur, veprimtaria e tij dhe e të vëllait, një personazh po ashtu me shumë vlera, herëherës del emri i tyre, por mesazhet reale të dy vëllezërve Ivanaj kanë humbur dhe madje, janë harruar. Madje, edhe atë ditë vjeshtë, 65 vjet më parë, kur do të ndërronte jetë, ai pothuaj ishte harruar. Kurrë nuk mund të kesh trishtim më të madh në të gjithë sesa të harrojnë. Kjo i ndodhi, njeri prej personalitetëve më të jashtëzakonshme të kulturës dhe arsimit shqiptar. I sfillitur, i stërmunduar, bashkëkohësit, kujtonin se të ndërimit i dukej më mirë të qëndronte në burg sesa të dilte jashtë hekurave ku nuk e priste askush. Artikullshkruesit e jetës së tij pohojnë se ai i drejtoi një letër drejtorit të burgut për t'i kërkuar ta mbante ende sepse nuk kishte asnjë të ardhur për të jetuar dhe po ashtu asnjë vend se ku mund të qëndronte. Dhe "u shpërblye" realisht, pasi më 22 shtator të vitit 1953 do të ndërronte jetë vetëm 12 ditë para mbarimit të afatit të dënimit të tij. Ishte 62 vjeç. Atëkohë, një moshë e denjë për moshën e tretë.

Dhurata e Maks Velos na kujton se ekzistojnë sërish njerëz që mbrujnë mesazhe, por edhe që nderojnë dhe me anë të këtij akti kujtojnë shqiptarët se puna e idealistëve nuk vdes asnjëherë. Ja pse dhurata e bukur e Velos, përjetësuar me 7 vepra, është kaq e lartë si akt.



Mesazhet e Velos.


Punët, që janë realizuar në pastel dhe në vaj, të përmasave të ndryshme janë vendosur tashmë në mjediset e këtij fondacioni dhe përbëjnë një dëshirë të kahershme të autorit në nderim të Mirash Ivanajt. Në fakt, Z. Velo, me angazhimin e tij të përhershëm publik është munduar që të japë mesazhe në të gjitha fushat. Ato rrokin nga apelet publike, por edhe krijimet dhe sidomos shkrimet publicistike për problematike të ndryshme. Në rastin tonë, ai përgatiti një cikël, kushtuar personalitetit të madh Mirash Ivanaj.



T

TREGIM

Një tregim i zgjidhur jashtëzakonisht këndshëm teknisht nga autori, duke na treguar aftësitë e tij në prozën e shkurtër por edhe aftësitë krijuese...



NGA ENVER KUSHI

Eshtuna pas disa orësh do t'ia linte vendin të dielës së fundit të muajit mars. Të gjithë televizionet që në lajmet e para të mëngjesit, vazhdonin të jepnin të njëjtin njoftim: Duke filluar nga ora 02 e së dielës, akrepat e orës shkonin gjashtëdhjetë minuta para. Më pas, njoftimi shoqërohej me komentin se kur ishte vendosur për ndryshimin e orës, pasojat që kishte ky ndryshim veçanërisht në shëndetin mendor të njerëzve, si dhe debatet e fundit në Parlamentin Europian për këtë problem.

Kisha vite që e prisja me ankth këtë natë ndryshimore, duke mos fjetur deri në orën 02 e pasi lëvizja përpara akrepat e orës së murit në kuzhinë, dhomën e gjumit, koridor, banjo, dilja në shkallët e pallatit e pasi ngjitesha në karrike, lëvizja edhe akrepat e orës së katit të tretë. Në katin e katërt ora prej gati dy vitësh nuk punonte, ndërsa në katin e pestë nuk kishte orë. Pastaj ndizja të gjitha dritat e shtëpisë, sikur të kishin ardhur miq të papritur dhe prisja jo pa ankth të binte zija e telefonit. Mbaj mend se një vit më parë, vetëm një minutë pasi "mori pushtetin" ora e re, ra zija e telefonit. E ngrita menjëherë receptorin dhe pa prituri akoma alon time, dëgjova zërin e alarmuar të një zonje: "Doktor! Doktor! Po më vdes qeni... I ka hipur një temperaturë e papritur dhe është shtrirë si i vdekur... Të lutem doktor... A mund të vini për ta parë vogëlushin tim, zemrën time që po rënkon? " Zonja fliste e fliste pa pushim dhe e alarmuar për gjendjen e qenit të saj, se shtëpinë e kishte të pallatet e reja, ku ngjitesh të "Komuna e Parisit", në katin e fundit e se do më duhej të ngjitesha në këmbë, për arsye të defektit të ashen-sorit... O zot, thashë me vete. Ç'është kjo telefonatë dhe ky zë kaq i alarmuar. Dhe pasi ajo pushoi vetëm pak caste, i thashë se nuk isha doktor për qentë, se ndoshta ka ngatërruar numrin e telefonit, se punoja si specialist i Trashigimisë Kulturorë në Ministrinë e Kulturës. Pas këtyre fjalëve, e ula receptorin e telefonit dhe pasi fika të gjitha dritat, shkova në kuzhinë dhe piva një gotë të madhe me ujë... Pastaj ra prap zija, por nuk e ngrita receptorin. Me siguri ishte zonja që kishte të sëmurë qenin ose ndoshta ndonjë tjetër... Hapa televizorin... Në orën tre e tre minuta, me të renë, 150 km në veri të Tiranës, ishin ndjerë lëkundje të forta tërmeti dhe nuk kishte të dhëna për dëmmaterialiale apo viktima në njerëz... Lajmin e lexoi një spikere e njohur dhe në të folurën e saj, ndihej ankth dhe alarm i çuditshëm. E njehta spikere pas pesë minutash, me të njëjtën të folur, por edhe me të shpejtë, njoftoi se

Pesë minuta pas ndërrimorës

mbi qiellin e Romës, një avion i linjës Romë-Paris, ishte zhdukur nga radarët. Ra prap zija e telefonit, që e ngrita pas disa ngurimesh... Megjithatë profesori çdo ditë, veçanërisht mëngjesëve, shëtiste në Parkun e Madh të Tiranës, pastaj ulej në sallën shkencore të Bibliotekës Kombëtare dhe shkruante ose lexonte e më pas mbyllej i vetëm në shtëpi i rrethuar me libra të shumtë dhe dhjetëra fotografi të rinisë e veçmas me gruan e bukur ruse, vajzat... Zakonisht e merrja më shumë unë në telefon sesa ai, sepse, siç më thonte, nuk donte të shqetësonte njeri. Kohët e fundit ishte bërë më i hesh-tur. Fliste më rrallë dhe kur uleshim të kafe "Flora" më shumë flisja unë sesa ai. Vështrimi i ishte bërë më i përhumbur. Vështronte e vështronte në një pikë të murit të lokalit, sikur kishte zbuluar diçka apo fliste në heshtje me shpirtin e gruas ruse Ana S.

Këto ndodhën në ndërrimorën e vitit të shkuar dhe nuk dua të kujtoj të njëjtat ndodhi në Tiranë, rrethe apo në botë, para ose pas këtij ndryshimi... Nuk e di se çdo të ndodhë këtë vit, mendova e teksa po ndiqja lajmet në televizor, ra zija e telefonit dhe më pas edhe ajo e celularit. Vetëm zile ranë. Pashë numrin në thirrjet e papërgjigjura. Ishte i prof. Stefan D. I njohur në fushën e studimeve minerare, veçanërisht të bakrit. E kisha njohur që para viteve '90, kur punoja si gazetar dhe kisha shkruar e botuar një portret në gazetën "Drita". Më vonë shkrova edhe një tregim të gjatë për jetën e profesorit, largimin e gruas së tij Ana S., ruses së bukur bashkë me dy vajzat, ngjarje shumë e dhimbshme, që profesori e kishte përjet-

uar aq keq, saqë ishte shtruar disa muaj në Spitalin Neoropsikiatrik të Tiranës e që kishte lënë pasojat në shëndetin mendor të tij. Megjithatë profesori çdo ditë, veçanërisht mëngjesëve, shëtiste në Parkun e Madh të Tiranës, pastaj ulej në sallën shkencore të Bibliotekës Kombëtare dhe shkruante ose lexonte e më pas mbyllej i vetëm në shtëpi i rrethuar me libra të shumtë dhe dhjetëra fotografi të rinisë e veçmas me gruan e bukur ruse, vajzat... Zakonisht e merrja më shumë unë në telefon sesa ai, sepse, siç më thonte, nuk donte të shqetësonte njeri. Kohët e fundit ishte bërë më i hesh-tur. Fliste më rrallë dhe kur uleshim të kafe "Flora" më shumë flisja unë sesa ai. Vështrimi i ishte bërë më i përhumbur. Vështronte e vështronte në një pikë të murit të lokalit, sikur kishte zbuluar diçka apo fliste në heshtje me shpirtin e gruas ruse Ana S.

...E mora menjëherë në telefon, duke e pyetur a ishte mirë dhe nëse duhej të lajmëroja urgjencën. Ai tha se e ndjente vet-

en mirë, por m'u lut që të shkoja ta takoja patjetër e se më priste atje ku nis rruga "Kont Urani". Do të vij menjëherë, i thashë, duke ju lutur që të më priste më mirë në shtëpi ose poshtë shkallëve të pallatit, ku banonte... Ai nguli këmbë që do më priste atje ku më tha, se tani po zbriste shkallët... Si të doni profesor, thashë. Jashtë fryn erë e fortë. Ka vite që në Tiranë nuk ka fryrë erë kaq e fortë, thashë duke mbyllur telefonin. U veshva menjëherë, pa harruar xhakaventën dhe çadrën, ndonëse jashtë frynte vetëm erë e fortë e nuk binte shi. Pashë orën. Donte edhe tri orë që akrepat të shtyheshin përpara. Jashtë era, që vinte nga Veriu, ishte aq e fortë, saqë dëgjoheshin kur binin antenat e televizorëve nëpër taracat e pallateve të rrugës së Kavajës ose vazo lulesh nëpër trotuare. Për t'u mbrojtur dola në mesin e Rrugës, ku kurorat e kumbullave të kuqe, putheshin të për-mallura me njera-tjetrën... I rashë prap numrit të telefonit të profesorit. Nuk u përgjigj... Kalova me vrap rrugën e Kavajës. Rrugica që

të nxirte në rrugën "Kont Urani" ishte pa drita. Ish godina e Institutit të Kulturës Popullore, dukej më e vetmuar dhe e braktisur në errësirën që e rrethonte dhe erërat e forta, që futeshin nëpër grilat e shqyera të dritareve... Nga bodrumet e saj, ku dikur ishte arkivi i këtij Instituti, m'u duk sikur vinin zëra rapsodësh, vaje dhe ca tinguj të trishtuar violinash apo melodi të vjetra, ndoshta të sazeve të Leskovikut. Muri rrethues i ish shtëpisë publike të Tiranës në kohën e mbretit Zog, ishte gati të rrëzohej, prandaj dola në mesin e rrugës... Pashë orën... Pas njëqind e dyzet minutash, akrepat e orës do të shkonin gjashtëdhjetë minuta përpara. Edhe pas njëqind e dyzet minutash... JoJo. Edhe pas njëqind e tridhjet e nëntë minutash, thashë gati me zë, kur pashë profesorin në trotuarin, ku nis rruga "Kont Urani"... E përgafova dhe i thashë se mund të më kishte prituri poshtë pallatit, se kjo erë e paparë që po frynte, veçanërisht në këtë orë pragmen-sante, për moshën e tij... Ai më dëgjonte me vëmendje, ndërsa në dorën e djathtë mbante kasketën e bardhë. Vura re që pardesynë e vjetër e kishte kopsitur keq, saqë ana e majtë i varej më poshtë se ajo e djathta dhe shalli gati-gati po i binte... I thashë se mund të uleshim në një lokal, por ai tha se ishte vonë e se frynte shumë erë.

- Mbështetu tek unë, - i thashë teksa kapërcyem Rrugën e Durrësit.

- Faleminderit, - tha. Të kërkoj falje që të nxora në këtë orë, - shtoi pas pak duke ecur me hapat e vegjël.

- Kur më telefonuat mendova se mos ishit sëmurë. - i thashë, teksa po afrohemish shkallës së pallatit ku banonte profesori.

Drita e zbehtë, që vinte nga një shtyllë pak më tutje, binte në hyrjen e pallatit, ku dukej motorpompë e ujit dhe një grumbull letrash dhe qesesh plastike, që era e fortë i ngrinte dhe i ulte, duke i përzier, si në një valle absurde.

- Ngjitem vetë lart, - tha profesori duke nxjerrë nga xhepi e brendshëm një zarf të vjetër, palosur në mes. - Merre, - tha duke ma zgjatur me duart që i dridheshin.

E mora zarfin, që ishte i mbyllur mirë. Me siguri ka shkru-



...nga numri i shkruar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë. Shkrimi kryesor iu la histori-anes së njohur Lucja Nadin për një hipotezë që ajo e ka elaboruar dhe më parë lidhur me amët e Skënderbeut, njeriut që i ka përgatitur ato në Venecia dhe e vërteta sesi ikën ato. Hipoteza e saj bën me dije se: pas hyrjes së francezëve janë djegur shumë dokumente dhe po ashtu edhe matrikulimet e armëve të tij, kështuqë sot ato nuk dihet se ku janë. Përkthimi ynë linte për të dëshiruar, por argumenti kuptohej.

Në këtë numër, në nderim të 70-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Moikom Zeqo, publikuam një cikël të poezive të autorit, që na u propozuan prej vetë tij. Me një sistem figuracionesh shumë të veçanta, ai na përcolli krijimtarinë e vet, që ka bërë shenjë në letrat tona.

Vlask Prifti, profesori i njohur i artit grafik në Fakultetin e Arteve të Bukura, na përcolli një përkthim të një esteti të njohur. Charles Taliaferro u soll me shumë dashuri, por autori duhet të ketë parasysh se është e vështirë përsh- taltaj nga teoritë estetike, ndërsa duhet të konsultohet ketë edhe për një re- daktor të mirë. E vlerësojmë gjithsesi kontributin e profesorit për përcjelljen e një autori me një peshë të tillë. "Meritat artistike duken të jenë çështje të disa faktorëve duke përfshirë: imagjinatën krijuese, aftësinë komunikuese dhe

ekspresionin, të vërtetën në veprën e artit, gjykimin e mirë apo të keq, të zvetënuar dashakeq e jo profesional, vlerat e mundshme religjioze apo shkencore dhe të mirat apo anët pozitive të ekzekutimit apo interpretimit artistik me vlerë si dhe sublimen e të bukurën".

Redaktori solli vetë një përkthim nga intervista e Olga Carlislle me Pasternak. Intervistuesja e shkrimtarit të njohur ishte një publiciste e njohur me origjinë ruse, e cila ka jetuar jashtë vendit të saj të origjinës. Në pjesën e parë të takimit të redaktore me Pasternakun, autorin e njohur të "Doktor Zhivagos", dhamë përsh- krimin që i bën ajo takimit shumë mbresëlënës me Nobelistin e njohur rus për Paris Review, kurse në vazhdim ajo na tregoi shpjegimin e tij për veprën e vet por edhe letërsinë ruse të dekadave të para të shekullit të shkruar...Redaktori duhet ta mbante më shumë përkthimin e tij.

Redaktori shtoi një shkrim për një temë që e ngacmon, lidhur me desidencën. "Ajo që quhet desidencë mund të merret e pastër nga fjalët e personazheve të ashtuquajtur negativë të filmave të Socializmit, që jepen realisht pa asnjë lloj titrimi në fillim të filmit", shkroi ai. Autori kosovar Bajram Sefaj na solli një argument tjetër, që ai e përshkruan brenda kanoneve të një proze urbane, siç i pëlqen ta quajë. Megjithatë duhet të themi se ishte realisht një numër i mirë dhe i realizuar qartë.

ar ndonjë studim shkencor, men- dova. Ai më kishte folur se kishte kohë që merrej me një studim për bakrin dhe riaktivizimin e buri- meve minerare dhe industrisë për- punuese në kushtet e ekonomisë së tregut. Ndoshta kërkonte që të merresha unë me korrektimin letrar të studimit. Ju luta edhe një herë që ta shogëroja deri në katin e tretë, ku kishte hyrjen, por duke më dhënë dorën, kërkoj prap të falur që më kishte nxjerrë në këtë orë të vonë nga shtëpia, veçanë- risht në këtë natë me erë të fortë e kur ndërrohej edhe ora... Natën e mirë, tha... Qëndrova derisa ai ngi- ti shkallët e katit të parë, pastaj ato të katit të dytë dhe kur u sig- urova që u ngjit në katin e tretë, u largova thuajse me vrap dhe kur po i afrohesha kryqëzimit të 21 dhjetorit, pashe orën... Kishin mbe- tur gjashtëdhjetë e pesë minuta nga ndërrimora. Frynte e njejtë erë, ndoshta më e fortë dhe rrugët ishin të zbraza. Ngjita me vrap shkallët e pallatit tim, hap me nx- itim derën dhe sapo hyra në shtë- pi, ndeza të gjitha dritat e dhomave... U hodha një vështrim të shpejtë të gjitha orave dhe atyre të murit, edhe të tavolinave. Pun- nin në qetësi të tyre, pa e ditur që pas pak akrepat do të shkonin gjashtëdhjetë minuta përpara... Zarin që më dha profesori e lashë të pahapur mbi komonë e dhomës së gjumit dhe u ula në kolltukun tim përballë ekranit të televizorit... Jashtë era ulërinte, ndërsa në ti- trat e ekranit të televizorit shkru- hej për erërat e forta që kishin përf- shirë bregdetin shqiptar, qytetin e Shkodrës, Lezhës dhe Shqipërinë Qendrore... Edhe pak minuta kish- in mbetur për ndërrimorën. Një- qind e tetëdhjetë sekonda... Nëntëdhjetë... Shtatëdhjetë e pesë... Gjashtëdhjetë e tre... Pesëdhjetë... Dyzetë... Tridhjetë... Dhjetë sekon- da... Erërat e forta përmbysin tri maune të mëdha... Kjo ka ndodhur në afërsi të urës së lumit të Matit. Shkatërrohen të gjitha serat në Sukth dhe Shijak... Ora një e pesëdhjetë e nëntë. U ngrita dhe mora orën e murit të kuzhinës. Fare e thjeshtë. Lëvizja akrepat para dhe ora shkoi atje ku duhej. Të njëjtën gjë e bëra edhe me orën e tjera të murit... Dola në ballkon. Në pallatin përballë të gjitha drit- at ishin të fikura, ndërsa era gati- gati po i shkulte rrapet në të dy anët e rrugës... E megjithatë qielli i natës mbi Tiranë ishte i njëjtë, ndonëse ora kishte lëvizur për- para. Edhe hëna e plotë e njëjtë ish- te. Edhe yjet e largëta... Edhe pal- latet... Edhe... U dëgjua zija e tele- fonit në dhomën e gjumit. O zot,

thashë me vete. Si vitin që sh- koi. Ishte e njejtë zile, që binte si në ka kohëra të tjera... Nuk e ngrita receptorin e telefonit... Pastaj zija e telefonit nuk ra më... Mora celularin në dorë dhe që nga aparati gri, dëgjova zilen e fortë. Me duart që më drid- heshin e afrova tek veshi. Zëri që dëgjova në celular m'u duk sikur vinte përmes erërave të forta të pasndërrimorës. Ishte një nga miqtë e profesorit, që e njihja edhe unë. Po fle, tha ai me zërin sikur vinte nga një kohë tjetër... I thashë se isha zgjuar e se para një ore a pak më shumë isha me profesorin, se... Profesori ndërroi jetë, tha ai. Në orën tre e pesë minuta me orën e re, ai ndërroi jetë... Dhe pa prituri re- agimin tim, më tha që të hapja zarfin që më kishte dhënë profe- sori, e pasi të shihja se ç'kishte në të, të vija në shtëpinë e të nd- jerit... Kaq tha miku i profesorit, me të njëjtin zë monotone, që vinte nga koha e ndërrimorës. Fjalët e tij m'u dukën si fjalë ën- drre. Profesori kishte ndërrua jetë në orën tre e pesë minuta të orës së re, përsërisja si në jerm fjalët e mikut të profesorit, pasi mora zarfin dhe e hapa... Nuk po u besoja syva. Të palosura me shumë kujdes dhe me shkrim dore, ishin dhjetë lajmëtime vde- kje. Më ra në sy një fotografi e bukur e profesorit, ndoshta dalë në moshë të mesme dhe fjalët: "Me hidhërim të thellë, njoftojmë vdekjen e Stefan D." Më poshtë ora e varrimit dhe vendi i varrimit: në një qytet të vogël në Veri, ku ai kishte kaluar vitet më të shumta të jetës si inxhinier. Ra prap zija e telefonit. Ishte miku i tij, i cili më tha se po më priste e më porositi që njoftimet e vdekjes së profesorit t'i vija te poliklinika e 21 dhjetorit e më pas te muri i ish Radio-Tiranës, rruga "Kont Urani", në hyrjen e pallatit të profesorit, Bib- liotekën Kombëtare dhe Minis- trinë e Industrisë...

Dola jashtë. Era kish- te pushuar... Kumbullat e Rugrës së Kavajës dukeshin sikur flinin, ndërsa kupa e qiell- lit të Tiranës, ishte pa hënën e plotë dhe yje. Profesori nuk ish- te më... Ecja me njoftimet e vde- kjes, shkruar bukur nga profe- sori e më dukej sikur mbaja në duar, në kohën e ndërrimorës, fisnikërinë, vetminë dhe dhimb- jet e heshtura të një jete, që u shua qetësisht në orën e re tre e pesë minuta...

Tiranë, fundmars 2019

P

POEZIA

NGA ARJAN PETERS

Përpara se të shkruante në vitin 1912 ciklin e poezive të njohura si "Jeta e Marisë", që janë botuar tashmë të përkthye- era [në holandisht] nga prifti mençurak Piet Thomas nga Leu- ven, Rainer Maria Rilke duhet të ketë hulumtuar një qerre me un- gjij dhe piktura. Kjo grua [Maria] nuk gjeti një çast të vetëm qetësie. Qysh nga lindja e saj, u gjend e rre- thuar nga engjëjt dhe apostujt, dhe e gjithë kjo trazirë vazhdoi edhe pas vdekjes së saj, deri kur vajti në vendin e saj në qiell.

Më e paqëlluar, është poezia e fundit e ciklit, kur një engjëll e qorton apostullin Thomas, pasi ai erdhi me vonesë dhe qëndronte atëbotë i pikëlluar në anë të varrit, ndër kohë që vetë Maria nuk është më aty. Përkthyesi e ka harruar fare rimën në fund të poezisë, me një përjashtim të vetëm, duke na shtyrë kështu t'i vemë më pak rëndësi formës dhe të përqendro- hemi më shumë te ky engjëll plot trishtim.

"Shih qefinin. Ç'e zbardh krejt, shkëlqimin aq qartë të pa- prekur?"

Drita e këtij trupi të pastër vetë, sa dielli i ndritshëm lini ka mbe- tur.

Nuk ju befason se si është bart? Si të jetë ende atje. S'ka lëvizur gjë.

Por qielli dridhet, lëkundet atje lart.

Bëj si unë, njeri, këndo e gjun- jët n'tokë vë."

Ajo që më shqetëson mua, është se ky apostull nuk le vend për heshtje dhe zi, atij i duhet të jetë i lumtur dhe të gjunjëzohet dhe të këndojë.

Unë vetë e kuptoj ndryshe Tho- masin. Dhe përligjen e qëndrimit tim, e gjej në përmbledhjen "Roja i dritës" së poeteshës shqiptare Flu-

Kritiku i njohur holandez shprehet për poezinë e Flutura Açkës. Paralele mbi vëllimin "Roja i dritës", botuar tashmë edhe në holandisht

Kurrfarë dritë a lehtësim

Te Rilke, Arjan Peters nuk gjeti vend për zi, sikurse në vargjet e Flutura Açkës

"Ka aritmi ora, minutat hanë thonjtë," shkruan poetja shqiptare Flutura Açka



tura Açka (1966), djali i vetëm i së cilës (17 vjeç) vdiq nga një sëmund- je e rëndë vitin e kaluar. Mes poezive të saj të përkthyer nga Roel Schuyt, unë zgjodha "Nata më e gjatë në jetë":

"Ka aritmi ora, minutat hanë thonjtë, vdekja jetës i hedh vargonjtë. Ti shushamë, e vetme zezërin në natën e zbrazët, e hesht pikur n'zi,

e pabëzamia këmbanë, shembur në anë, lëshon tinguj vaji tani.

Nata më e gjatë në jetë, natë mbet."

Nuk shquhet anjë dritë aty apo ndonjë lehtësim. Paqja e saj e vet- me është se nuk do të ketë ndonjë engjëll që ta qortojë e ta shtyjë t'i japë fund zisë së saj.

Amsterdam, 24 maj 2019

K

KRIJIM

Visar Zhiti nuk bën "pronarin e fjalës", por të dashurin intim të saj, ai është vena e zgjedhur e gjakut, përmes të cilit fjala i shpërndahet botës në formën e pastër dhe në formën primare të poezisë. Visar Zhiti është vendi prej mishi, gjaku, eshtrash dhe emocioneve në të cilin fjala trupëzohet dhe rritet, rrumbullakësohet, bëhet e plotë, që më pas t'i shpërndahet botës.

VISAR ZHITI, MBJELLËS DRITE...



NGA ANA BARTON*

Ekam dashur Visar Zhitin qysh para njëzet e pesë vjetësh, ndonëse sot e takoj për herë të parë. Kam takuar poezinë e tij falë Luan Topçiu, i cili më tregoi për shkrimtarin e madh, duke përkthyer ad hoc disa nga poezitë e tij. Lidhja u bë atëherë, e padukshme, e përbërë, dhe poezia e Visar Zhitit filloi të jetojë përmes meje dhe nuk u ndal askurrë. Kamaret e zemrës janë të johapës-inorta, kështu që shumë, mund të

hyjnë në to, poezi, vise, poema, kurora pemësh të lulëzuara, dhimbje që buron nga toka, gjaku i shpirtit, hyjnë të gjitha të kashtosura, por pa shkelur këmbët e akëcilit "[...] Edhe trenat flenë në stacionin e fundit./Edhe unë do të vij të rri në buzët e tua,/të shëtisim bashkë nëpër flokët e tua/si në një pyll./Do ta tremb frikën tënde/ si pasqyrimin tënd mbi ujërat që fërgëllojnë,/do ta gëzoj gëzimin tënd/si një hënë pranverë që e mbushim me yje anash./të gjitha dredhitë e jetës/me dredhi do t'i bëjmë të mira si e qeshura,/ si dhimbja,/ si besnikëria./ Do të vij, patjetër do të vij./ jo si ankthi i të trokiturave në derë,/as si një letër e futur poshtë saj. Do të vij./ i butë si zjarri, i egër si zjarri, i ngrohtë si zjarri,/ i marrë dhe i mençur si zjarri,/ tek ty do të vdes si zjarri që s'vdes.

Itillë ka qenë takimi me njeriun që arti i të cilit ka vuajtur dhe u martirizua për lirinë për të shkruar poezi, për lirinë për t'u shndërruar në dritare nga del në botë poezia, sepse guxoi të ndjejë në mënyrë



"të trishtë dhe hermetike", të cilat u përkthyen në kohën e diktaturës si armiqësi ndaj popullit.

Visar Zhiti nuk bën "pronarin e fjalës", por të dashurin intim të saj, ai është vena e zgjedhur e gjakut, përmes të cilit fjala i shpërndahet botës në formën e pastër dhe në formën primare të poezisë. Visar Zhiti është vendi prej mishi, gjaku, eshtrash dhe

emocioneve në të cilin fjala trupëzohet dhe rritet, rrumbullakësohet, bëhet e plotë, që më pas t'i shpërndahet botës.

Visar Zhiti - vendi i kalimit mes botës dhe ai e di shumë mirë se si është atje, por e di si është dhe përtej, dhe me gazmim dhe përlusësi ai shndërrohet në një urë. Ndihet si në poezinë e tij sesi fjala është ekstaza e heshtjes, energjia e

fjalës është ajo që hyn tek njeriu pa lënë plagë tek ai, hyn dhe zë vend, nuk frikëson, nuk zemëron, përkundet duke kënduar me gjakun e personit ku ka hyrë, e zbut dhe e pranon, e krip atë pak dhe e bën më përvëluese, sepse njeriu të mbetet ai që ka qenë që në gjenezë: dashuri, sepse nga dashuria ka ardhur dhe në dashuri do të kthehet. Dashuria është toka e njeriut. Kjo tokë në të cilat Visar Zhiti hedh rrufet për ta mbjellë përjetësisht dritë.

*ANA BARTON SHKRIMTARE,

një nga prozatorët më të njohura dhe më popullore të Rumanisë së sotme. Ka shkruar herët, por ka debutuar vonë, 40 vjeçe. Ka shkruar me qindra artikuj në shtypin letrar: Ka botuar librat: "Prospekt i një gruaje", "Mamifer dhe Betimi i humbjes së udhës", "Parvazi i Zotit", "Libri indjesive", vëllimin kolektiv; "I pavdekshmi i zakonshëm", etj.

(Përkthet L. T.)

5 poezi nga libri "Flatër e mundur" i Visar Zhitit, botuar në Rumani

Do të vij përsëri, do të vij,
do të vij, do të vij patjetër.
Çastet le të bëhen kopsat e fustanit
që ti të dalësh të më presësh.

Do hap një rrugë mospërmas harrimit
dhe do të vij.
Do të shtyj lotët me duar
dhe do të futem në sytë e tu.

Edhe dallëndyshet vijnë
tek ajo pak balte e tek ato fije bari
që quhen fole.

Edhe trenat flenë në stacionin e fundit.
Edhe unë do të vij të rri në buzët e tua,
të shëtisim bashkë nëpër flokët e tua
si në një pyll.

Do ta tremb frikën tënde
si pasqyrimin tënd mbi ujërat që fërgëllojnë,
do ta gëzoj gëzimin tënd
si një hënë pranverë që e mbushim me yje anash,

të gjitha dredhitë e jetës
me dredhi do t'i bëjmë të mira si e qeshura,
si dhimbja,
si besnikëria.

Do të vij, patjetër do të vij,
jo si ankthi i të trokiturave në derë,
as si një letër e futur poshtë saj. Do të vij,
i butë si zjarri, i egër si zjarri, i ngrohtë si zjarri,
i marrë dhe i mençur si zjarri,
tek ty do të vdes si zjarri që s'vdes.

A JANË BËRË MË TË MIRË VRASËSIT TANË?

A janë bërë më të mirë vrasësit tanë?
S'e kam fjalën a dinë të vrasin më mirë,

tani që janë më të pasur dhe merren
me biznes dhe jashtë shtetit, jashtë fatit.
Të zbardhur ushqejnë macet, qenin e zi.

(Kafshët e urta rinë dhe me ta.) I përkëdhelin
sikur qetësojnë një mëkat
të (pa)harruar.
Herë pas here çezmat e tyre rrjedhin gjak
e kur dëgjojnë trokitje,
seç kanë një frikë të papërcaktuar...
çojnë gratë të hapin derën. (Gjithmonë ato kanë
prirë...). (Si flakë e shuar pishtarësh në korridoret
e errët). (...kanë filluar të besojnë në fantazma...).

A janë bërë më të mirë vrasësit tanë,
se të vrasit e tyre s'dinë të bëjnë asgjë,
as të edukojnë.

Bruksel, 18.III.'94

JANË ZBUKURUAR PLEHRAT NË ATDHEUN TIM

Janë zbukuruar plehrat në atdheun tim,
s'janë siç kanë qenë, vetëm lëkura patatesh
(si të shkulura në tortura), gjak domatesh të prishura,
lëvezhga vezësh e thonj, qepësh e lotë të tharë, këpucë
të pakalbura ende, potkonj, mace që s'kuptohet a janë
gjallë, copa gazetash - ngjarjet e botës të flakura
në kazanet anash rrugëve si mëzë
e madhe, kërcënuese...

Janë zbukuruar plehrat në atdheun tim
dhe janë shtuar bashkë me lirinë, ngjyra-ngjyra si letra
çokollatash vezulluese, si idetë, si fundi i një ëndrrë
në mëgjes, fotografi lakuriq artistësh,
të ndaluar më parë

të gjitha, gjëgjëza ambalazhesh, modë, lule të thara,
mbeturina bananesh si hëna të shtrembëruara,
dekorata, gëzhoja, kuti të bukura pijesh të jashtme,
e jashtëmja e brendshme, kapakët e shqyer
të librave të diktatorit, koka e tij e statujtë, pis,
buzëqeshja e thyer, poemat për të, një gjysmë
magnetofoni, plehra të shtrenjta, kënga ende dëgjohej,
e ngjirur, kollukë më tej, televizor, skelet veture përsipër
si një tërmet. Ja, ca furça të reja dhëmbësh
si picirrukë përrallash të pa mbaruara.

Pirgjet me plehra vazhdojnë jashtë rradhëve
të kazanëve të mëdhenj,
pasqyra ku fërgëllojnë ballkone pallatesh të larta, po qielli
prapë është larg, larg dhe i pastër ende, veçse nja dy heronj
se ku janë zhgërryer, punë korupsioni, pranga
të ndryshkura...

Kalojmë anash plehrave, mospërmas plehrave,
sa shumë, edhe në biseda, gjithandëj, çfarë plehërash, -
plehra në kujtesë, në qëndrim, në karrierë,
plehra, plehra, plehra.

Dhe ato të rrugës ndonjëherë janë
më pak të shëmtura, të dëmshme më pak.
Janë zbukuruar plehrat në atdheun tim! Pse vetëm ato...

FOLETË E ZBRAZËTA

Sa shumë, gjithë ato fole dallëndyshesh,
në rresht, pranë e pranë,
nën një çati vjeshtë buzë ujërash. Fol?
të zbrazëta si pikëllimi në sytë e tu të mëdhenj

Visar Zhiti në ndërgjegjen kombëtare



NGA DR. LUAN TOPÇI

(Parathënia e librit "Aripa Fran-ta"/ Flatra e mundur", me titull POEZIA - LIRIA QË NUK MUND TË PRANGOSET)

Pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri, si në çdo vend tjetër të Lindjes, u prit të dilte në dritë "letërsia e sirtarit", siç është bërë zakoni të quhet letërsia e censuruar, e pabotuar, dhe letërsia e burgjeve. Pas shumë dëshmiave për dhjetëra dorëshkrime, vepra të pambaruara, drama e romane të shkruara në këtë atelie të ferrit njerëzor - dolën në dritë poezi, romane dhe letërsi që do t'i nënshtroheshin kriterit estetik dhe konkurrencës me letërsinë e botuar.

Një nga shkrimtarët më të talentuar, që kaloi nëpër ferrin komunist do të ishte Visar Zhiti, vepra e të cilit pasuron letërsinë shqipe me një përvojë të panjohur, me një zë që poezia e tejngopur dhe tepër lumtur komuniste nuk e njihte. Visar Zhiti solli në poezinë shqipe pamje nga ferri komunist, përvoja rrëqethëse që do t'i përjetonte vetë si viktimitë e komunizmit.

Poezia e tij ishte bashkëmoshatore me poezinë e realizmit socialist, e shkruar si në kor e komandë, plot me optimizëm, pa njohur trishtimin, vuajtjen, persekutimin, shqyrtjen e lirive. Çfarë mund të shënonte një poezi kombëtare që nuk e njihte trishtimin - këtë gjenerator themelor të poezisë - një poezi që nuk e njihte humbjen, pendimin, brengën, melankolinë, vetminë, që nuk njihte praninë e frikën ndaj Zotit etj. Poezia e Visar Zhitit është pjesë nga e vërteta tragjike, pjesë nga e pathëna dhe e papranuara, është një letërsi që u gatua në errësirën, ku komunizmi u përpoq të mbyllte intelektualët, artistët, zëdhënësit e lirisë. Letërsia e burgjeve ishte një radiografi e shoqërisë shqiptare të kohës, e kryer në pjesën më të dhimbshme e më të turpshme të shoqërisë, në vendin ku shqiptari shtypte shqiptarin që mendonte ndryshe. Me daljen në dritë të kësaj letërsie do të kryej një akt drejtësie në ndërgjegjen kombëtare dhe letërsia shqiptare, aq deficitare ndaj të vërtetës, do të fitonte një përmasë që i mungonte. Me veprën e Visar Zhitit ndërgjegjja e vvarë kombëtare do të rifitonte diçka që e kishte humbur në 50-vjetet e fundit. Zëri që vinte nga kjo "heshitje" ishte tronditës, i rëndë, tragjik - ishte zëri i thellë i ndërgjegjes së lënduar, së shtypur. Ndërgjegjja nacionale kryente një akt pajtimi me vetveten, duke botuar atë pjesë



të krijimtarisë kombëtare që ishte mohuar të shihte dritën e botimit.

Visar Zhiti, poeti që u burgos në moshën 27-vjeçare, pa mundur të afirmohej plotësisht si poet, dënohet për disa poezi të pafajshme dhe detyrohet të kalojë disa nga vitet më të bukura të jetës në burgjet famëkeqe të Spaçit, Qafë Barit etj. Umberto Eco, një nga mendimtarët më të mëdhenj të kohës tona, do të shprehej kështu për nocionin moral, juridik dhe etik të pafajësisë së poetëve të dënuar për shkak të poezisë, duke e ilustruar argumentin e tij me poetin shqiptar Visar Zhiti: Sa e gabuar ishte parathënia e vëllimit të më-

parshëm, duke thënë se kishte për qëllim të përkujonte "mbijetesën e shumë shkrimtarëve që u burgosën padrejtësisht gjatë këtyre shtatëdhjetë e pesë vjetëve". Pse "padrejtësisht"? Me të drejtë, do të thoja unë, të paktën nga pikëpamja e regjimeve që i arrestuan dhe i dënuan ata. Për të justifikuar nevojën e dënimit, nuk është e nevojshme që një shkrimtar të veprojë si subjekt politik, por ashtu si Zenone, ai komploton në mënyrë aktive kundër tiranit.

Shihet qartë në këtë libër rasti i Visar Zhitit: mjaftoi të shkruante poezi të konsideruara nga redaktorët e një shtëpie botuese "të trishtuara dhe hermetike" e pra, kundër regjimit. Pastaj, praktika i kaloi automatikisht Komitetit Qendror të Partisë Komuniste shqiptare e Ministrisë së Brendshme dhe Zhiti fitoi drejtësisht dhjetë vite burg. Kjo poezi i shkakton frikë regjimeve autoritare e diktatoriale edhe nëse flet, si në rastin e Zhitit, edhe për trëndafila.

Por koncepti "letërsia e sirtarit" nuk është aq i vlefshëm për poezinë e Visar Zhitit, sepse krijimi i saj bëhet në rrethana të jashtëzakonshme, ashtu siç do të dëshmonte vetë poeti: "Në fillim nuk i shkrova, por i krijova me mend, mes mureve ciklopike të qelisë, në vetmi e ankth, i thosha dhe i thosha me vete që të sfidoja absurdin dhe tmerrin, hetuesinë dhe boshirin. Poezia do t'i bëhet e njohur publikut shqiptar pas viteve '90. Visar Zhiti boton disa vëllime poetike "Kujtesa e ajrit" 1993, "Hedh një kafkë të këmbët tuaja" 1994, "Mbajllja e vetëtimave" 1994 etj. dhe së fundmi, më 2018 në Itali një tjetër përmbledhje në dy gjuhë "Nata është atdheu im". Poezia e Visar Zhitit - është ajo që krijohet kur njeriu ndodhet në zgrip të jetës, i gjendur atje ku është vështirë të shohësh një pikë dritë (në kuptim të figurshëm dhe të drejtë-përperdrejtë), në pikën - limit, ku vdekja është e pranishme, më pranë se kurrë. Poezia shndërrohet në mbrojtësen e tij - mbrojtësen e njeriut të pambrojtur. Nga kjo posturë e skajshme, poezia është shpëtim mendor dhe ekzistencial. Njeriu Visar Zhiti do të ndihet i lidhur ontologjikisht me poezinë, shkaktare e burgosjes së tij, do të shndërrohet në dashuri shpëtimtare. E krijuar si një krijesë e ndaluar, e rrezikshme, kanosëse, e paparashikueshme, tërheqëse deri në aventurë, mik-luese deri në mëkat, poezia e Visar Zhitit nuk është një produkt komo-modal profesional, por një përjeksion e mbinatyrshe, një kapërcim, një hop mbi kufijtë e njohur. Kjo poezi nuk është një poezi ludike, e krijuar për të kënaqur e luajtur me flakët dhe kombinimet e tyre, por për të kryejë këtë lojë të rrezikshme dhe ekzistencialë njëherazi. Krijimi është një problem i rëndë ontologjik. Poezia e Visar Zhitit, kjo parajsë-ferr, kjo liri-robëri, ky dënim dyfish, është një akt sublim. Poeti ka vendosur të flasë, sepse është i dënuar të shprehet, të kuvendojë. Duke folur do të thotë të kalosh përtej - në hapësirën imagjinare - në një çlirues të kohës shkatërruese. Liria duhet të jetë çlirimi nga rreziku i vdekjes

dhe dhunës. Poezia, shkaktarja e burgosjes, poezia shtati i vetëm i lirisë, flatra e mundur dhe e vetmja e arratisë. Krijimi - ky mohim i vdekjes - shpëton mentalen dhe shpirtëroren tek poeti. Visar Zhiti, ndonëse pikturon pa e kozmetizuar gjendjen e tij, e sposton lirinë në një terren të papushtueshëm prej askujt, sepse kjo zonë është e dominuar nga subjektiviteti tërësisht i pakontrollueshëm: Duhet shpëtuar fjala/ Duhet shpëtuar kënga deri sa gropat e ditëve të mbillen me mollë/ Le të na i pushkatojnë ballet, giaku im do të hedhë rrënjë/ Dhe do të lulëzojë. (Molla e dënimit)

Poezia është liria e paburgosshme. Poeti dëshmon se pikërisht këto zona të shpirtit janë të papushtueshme, ato prodhojnë liri dhe janë liria vetë. As gardianët, as sigurimi nuk mund të burgosin shpirtin e poetit, për fatin e tyre të keq, shpirti i poetit nuk mund të mbyllet. Tekstet, duke qenë se janë të endura (të radhitura, sepse sipas pohimeve të autorit kanë origjinë orale, si vetë gjejeza e vërtetë e letërsisë) në rrethana të skajshme ekzistenciale, nuk kanë shenja artificesh, kërkimesh formale, por burojnë natyrshtë, plot plasticitet, duke u rrekur të thonë të vërteta të mëdha dhe përfundimtare. Kjo lloj poezie nuk ka kohë për poza, modë, trille, gjejeza të mistershme e tejet elegante - impaktin ajo e krijon me dëshmitë rrëqethëse, me mesazhin e saj nga "shtëpia e vdekjes". Të tilla mesazhe do të dërgonin Dostoevskij, Lorka, Sollzenicini, Stainhard, Mitrush Kuteli, Petro Marko etj. Përpjekja për të thënë gjëra përfundimtare, të formuluar në kushte të skajshme jetësore - dëshmon energjinë e fshehtë e mbinatyrore të poetit. Poezia do të jetë rruga e komunikimit me botën - komunikimi i ndaluar, poezia do të jetë dashuria - dashuri e ndaluar, poezia do të jetë bota - bota e ndaluar. Poeti nuk nisat nga ndjesia e formës, por nga vetë ndjenja. Struktura e tij introvertet, e ndjeshme, e trishtuar, zhvillohet përmes një impulsi rrëfyës, si një protestë dhe një thirrje implicite për ndihmë, dhe një aspekt emocional brut, duke u gjendur më pranë rrënjëve të lirisë. Poeti është i joshur të njohë, të përshkruajë me rigorozitet, shumë nga iluzionet, ëndrrat e veta, vuajtjet e veta - për të mos i lënë të vdesin. Zëri i tij është i thellë, tragjik për atë çka dëshmon. Goethe fliste për poezinë se është rregullator i imazheve. Poezia e burgut është vetëm njëra anë e poezisë së Visar Zhitit, por pa dyshim, më relevantja në vëllimin "Flatra e mundur". Përmes këtyre pamjeve të tmerrshme, rrëqethëse, shokante, poeti krijon poezi, art - ashtu siç do të shprehej Majakovskij se poezia zëvendëson bukurinë e thjeshtë të vdekjes në një tjetër bukurri.

Visar Zhiti, vjen përpara lexuesit rumun me librin i tij të tretë Flatra e mundur/Aripa Fran-ta. Diçka e re në këtë edicion është se po botojmë poezi të shkruara në Rumani gjatë vizitave të tij në Bukuresht, Konstancë, Curtea de Argeș, Sinaia; shumica e shohin dritën e botimit për herë të parë.

e të errët, kur s'është fytyra e dashur në ninëz. Si t'i duroj këstu foletë, njëra pas tjetrës bosh, kur zemrën e kam plot

me fërfëllima flatrash?
Me se t'i mbushim, Zonjë rumune,
e bukur dhe dramatike
si tradhtia bashkëshortore?

Trokëllimat e takave të tua
mbi monotoninë e pllakave të ditëve
a mund të bëhen cicërima
për zbrazëtirat,
aq të ngjashme me këto fole të mjera?
E si mund të iki nga Rumania,
po nuk morën jetë,

ashtu në rresht të gjitha,
ato përzjerje fijesh bari të thatë me pakëz baltë -
zgavra të zgrroqçeta si vitet e tejkaluara të njeriut.
Puthjet e munguara -
mungesa e foleve,
të plasaritura vende-vende si rrudhat
në anë të majave të gjinjëve.
Mos janë gjinjët tuaja në mur ato fole?
Ju kemi murosor,
se ballkanas jemi,

e ç'nuk bëjmë me dashuritë?!
... sisët jashtë, të brejtura
nga dhëmbë prej ankthesh dhe pengjesh,
nga thonjtë e takimeve të rritura nga ndarjet,
nga vera e derdhur mbi to e lumturisë së një nate,
nga thëthitjet, jo vetëm të fëmijëve të palindur, por
dhe të etërve të tyre që gjithmonë ikin
dhe mbeten në murin e ftohtë foletë bosh.
Ç'po shoh këstu, skelet dallëndysheje
apo gërshtë të rëna për tokë,
q'ke për të prerë, ç'do të qash? ...
Të mbështetësh kryet në supin tënd,
pas të cilit vazhdojnë malet Karpate,
që s'i ndiejnë vuajtjet,
prandaj s'vdesin, por edhe s'jetojnë.

Se mos janë gjinjët e fryrë të tokës që vdiq lehonë,
malet...?

Asgjë s'mendoj dot,
koka më bëhet e rëndë -
fole e rënë nga mure të padukshëm,
që aq shpejt krijohen në jetë.
Po ç'dëshira kanë flatruar për tek ty

dhe pse u druhesh zbrazëtirave prej folesh?
Se si djeqin në fund të barkut, si një dhembeje
që s'di ç'të thotë as gjinekologu.
E tëra prej qumështi dhe dite, ti,
e mbushur me ëndje të reja, afroresh
si të huajt që do të ikë përgjithmonë dhe larg.
Ah, "përgjithmonë"

është më larg
se të gjitha largësitë, se çdo i huaj më e huaj!
Por mos ja fshij kësaj ore të kuqin e puthjes
me shamizën rumune, s'besoj
se e mban vetëm për kaq. Është flatër
në çantën tënde. Pa atë ndezulli giaku
në buzë,
pa atë plagomë, më e plagosur do të ishte jeta,
Zonjë! Muga më burrë më kanë bërë plagët,

s'e di a më të mençur,
por më të dashuruar, patjetër!

Curtea De Arges, datë e harruar.

* * *

Siç duket
unë jetoj brenda në syrin tënd.
Bashkohen qerpikët,
vjen nata për mua,
e ngrohtë.

Gjumi im rrëzon rrobat si gjethe të mëdha.
Kur të tretëm, të mos të di gjë
që jam ajo pemë në largësi.
Zogjtë ndërtuan një fole. Është zemra
ime. Pastaj dhe një zemër tjetër
me fije drite
dhe me kokrriza dheu si dhimbja.
Te krahët e mi e ndërtuan zogjtë. E dija,
është zemra jote. E pashë
kur hape sytë dhe solle agimin tim.

Kam kaq kohë që jetoj në syrin tënd.
Dhe që të të shploh,
dal herë pas here shëtitje
në formën e kulluar të lotëve.

R

REVIEW

Kur mbaron së lexuari këtë vepër të fundit të Mira Meksit, në të cilën edhe tregimet janë njëri më joshës se tjetri, lexuesi i vëmendshëm dhe me kulturë filologjike rri e përsiat, duke arritur në përfundimin se vepra artistike e kësaj shkrimtareje të talentuar është mishërim i përgatitjes enciklopedike, i erudicionit dhe i kulturës së lartë gjuhësore, e cila është e pamundur pa zotërimin e universit të pasur të leksikut. Dhe Mira Meksi e zotëron në përsosmëri këtë univers...

MIRA MEKSI, një shkrimtare erudite

NGA PROF.DR. ESHREF YMERI

Në veprën më të fundit "Hakmarrja e Kaza novës", ku përfshihet novela me titullin në fjalë dhe 16 tregime, vepër kjo që u prezantua në panairin e librit të këtij viti, Mira Meksi i zbulon lexuesit vetëvetësinë (individualitetin) e Xhakomo Kazanovës, për të cilin Dos-tojevski (1821-1881) thotë:

"Individualiteti i Kazanovës është njëri nga më mbresëlënësit e kohës së vet".

Autorja, për herë parë në letërsinë shqipe, shpalos para lexuesit një figurë komplekse të shek. XVIII, si Xhakomo Kazanova (Giacomo Girolamo Casanova - 1725-1798), një aventurier italian ky, qejfli udhëtues dhe shkrimtar, autor i jetëshkrimit të hollësishtë me titull "Histoire de ma vie" (Historia e jetës sime).

Mira Meksi është plotësisht e vetëdijshme se skalitja e një figure historike në një vepër artistike është një detyrë bukur e vështirë. Kjo për arsye se shkrimtarit, së pari, i duhet të sigurojë një informacion shterues për jetën e figurës në fjalë, jo vetëm brenda rrezes së jetës personale, por edhe brenda rrezes së ngjarjeve që shpalosen në mbarë shoqërinë ku heroi i veprës jeton. Së dyti, shkrimtarit i duhet të jetë tepër i vëmendshëm në respektimin "prerjes artistike" të veprës, për të mos i lejuar vetes të bjerë në historizëm.

Për arritjen e këtyre dy objektivave, shkrimtarit i duhet një përgatitje enciklopedike, i duhet erudicioni, aq i domosdoshëm ky për ta nxitur dhe për ta mbajtur të ndezur kërshtërinë e lexuesit.

Erudicioni është thellësia, shkëlqimi dhe hapësira e dijeve që sigurohen si rezultat i arsimimit, i formimit intelektual përmes leximit sistematik të veprave nga burime letrare dhe jolettrare. Fjala e latinishtes "erudire" do të thotë "nxjerr nga mosdija, pajis me dije". Rrjedhimisht, një shkrimtar me përgatitje erudite ka aftësinë të bëjë vlerësime kritike mbi bazën e logjikës deduktive.

Erudicioni shpërfaqet ndjeshëm në krijimtarinë e Mira Meksit. Ai bie në sy në të gjitha veprat artistike që ajo ka botuar deri tani. Këtu po përmend vetëm romanet "Planeti i ngrirë", "E kuqja e demave", "Porfida - Ballo në Versailles (Versailles)", "Frosina e Janinës", "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë", pa u ndalur në përmblidhjet me tregime.

Tomas Karleil (Thomas Carlyle - 1795-1881), shkrimtar, publicist, historian dhe filozof anglez me prejardhje skoceze, autor i veprës me titull "Heronjtë, nderimi i heronjve dhe heroikja në histori", botuar në vitin 1856, ka lënë për brezat pasardhës një aforizëm me fare pak fjalë, por me një domethënie fort të thellë:

"Shkrimtari është një shërbëstar i shenjtë".

Ai predikonte kultin romantik të heronjve, të këtyre personaliteteve të jashtëzakonshme, të cilët, me bëmat e tyre, kryejnë një mision hyjnor, duke e shtyrë njerëzimin përpara dhe duke u ngritur mbi turmat e njerëzve me formim të mangët.

Domosdo që misioni hyjnor i heronjve të veprave artistike është reflektim i drejtpërdrejtë i misionit hyjnor të shkrimtarëve. Kuptohet vetvetiu që ky mision hyjnor nuk mund të kryhet pa një përgatitje enciklopedike. Erudicioni i Mira Meksit është me të vërtetë sa befasues, aq edhe frymëzues për brezat e rinj të letrave shqipe, por edhe tepër joshës për masën e gjerë të lexuesve. Prandaj, sa herë që një vepër e saj prezantohet në panairin e librit në vjeshtën e çdo viti, lexuesit i shikon në radhë, në pritje për të marrë një autograf nga autorja në ballinën e librit të sapoblërë.

Me magjinë e fjalës artistike, Mira Meksi ka arritur të plazmojë mjeshhtërisht figurën e Kaza-

novës, i cili qe bërë aq i famshëm me morinë e aventurave dashurore, sa që emri i tij, nga i përveçëm, qe bërë i përgjithshëm dhe në ditët tona përdoret në kuptimin "femrajoshës" apo "femramashtues".

Përmes punës kërkimore të dy heronjve kryesorë të novelës, profesorë të arkeologjisë dhe të historisë së lashtë, të cilët janë vënë në kërkim të veprës së Kazanovës "Manuale dell'amore, Mira Meksi hedh dritë mbi "odisenë" e jetës së Kazanovës.



Suksesi i jashtëzakonshëm që pati vepra "Historia e jetës sime", e kushtëzuar nga moria e peripecive të jetës dhe e aventurave dashurore, e pati shndërruar figurën e Kazanovës në njëherë prej legjendave të kulturës botërore. Stendali, Alfred de Myse, Delakrua dhe të tjerë ishin të entuziazmuar nga kujtimet e tij.

Kur bën fjalë për varganin e aventurave dashurore të Kazanovës, Mira Meksi shkruan:

"Ai është

kryemjeshtri i artit të dashurisë, ku femra është përëndesha, kurse mashkulli skllav i saj".

Por mes gjithë morisë së dashurive të aventurierit profesionist, autorja, tek e bën lexuesin ta mbajë frymën pezull, ndalet në dashurinë e Kazanovës për francezen e bukur Henriette, e cila, me kalimin e viteve, qe shndërruar në "pengun më të rëndë të zemrës së venecianit".

Është e vërtetë që emri i Kazanovës lidhet me përfytyrimet për aventurat e tij dashurore, emër që vendoset në të njëjtën radhë me personazhe të tilla të botës artistike perëndimore, si Don Zhuanit i mirënjohur, Lovelasi [personazh i romanit epistolar "Klarisa" të shkrimtarit anglez Samuel Richardson (1689-1761), dhe Foblasit [heroi i romanit "Aventurat e kavalierit Foblas" (Le amours du chevalier de Faublas) të shkrimtarit francez Zhan-Batist Luvet de Kuvre (Jean-Baptiste Louvet de Couvray - 1760-1797)]. Është e vërtetë që në kujtimet e Kazanovës, në të cilat ndihet aroma e filozofisë së lirisë së individit, nuk anashkalohej odiseja e bërmave të tij seksuale. Megjithatë, në novelën e Mira Meksit individualiteti konkret i Kazanovës kristalizohet në një mënyrë më komplekse dhe më interesante. Prandaj, në një sërë studimesh që i janë kushtuar figurës së tij, jo më kot janë bërë përpjekje për ta paraqitur në një mënyrë më tërësore, si një aventurier me kulturë të gjerë dhe mendjemprehtë.

Kur mbaron së lexuari këtë vepër të fundit të Mira Meksit, në të cilën edhe tregimet janë njëri më joshës se tjetri, lexuesi i vëmendshëm dhe me kulturë filologjike rri e përsiat, duke arritur në përfundimin se vepra artistike e kësaj shkrimtareje të talentuar është mishërim i përgatitjes enciklopedike, i erudicionit dhe i kulturës së lartë gjuhësore, e cila është e pamundur pa zotërimin e universit të pasur të leksikut. Dhe Mira Meksi e zotëron në përsosmëri këtë univers. Ajo gërmon në "xeherorët e pasur" të shqipes sonë hyjnore dhe, me një pasion të lakmueshëm, vjel dhe krijon fjalë plot aromë amtare, krijon kompozita fort të goditura, ca kapërthime të bukura fjalësh këto, të cilat të kujtojnë kapërthimin e magjishëm të artistëve në një skenë balleti.

Kur lexoj prozën artistike të Mira Meksit, më vijnë në kujtesë ca përcaktime mjeshhtërore të shkrimtarit të shquar rus Konstantin Pautovski (1892-1968). Këto janë përcaktime që ai bën për shkrimtarin. Ai shkruan:

"Një shkrimtar që ka për zemër përsosmërinë e formave arkitekturore, në prozën e vet nuk e lejon një kompozim të ngarkuar dhe të plogët. Ai do të mundohet të arrijë përpjestimin e pjesëve të veprës dhe rreptësinë e gdhendjes së fjalëve. Ai do të shmangë morinë e zbulimeve venitëse të prozës, të ashtuquajturin stil ornamental".

Lexuesit këshërimtarë të veprave të Mira Meksit i merr malli që atë ta shikojnë më shpesh në ekranet e televizioneve. Por ajo, siç e ka përcaktuar bukur fort njëri nga personalitetet e kulturës shqiptare, akademik Flori Bruqi, "mbyllet në "kullën e fildishtë" për të shkruar libra". Por kur Mira Meksi zbret nga lartorja (piedestali) e "heshtjes" së saj dhe shfaqet para lexuesve në ekranet televizive, ata janë të bindur se ajo do t'u sjellë një tjetër surprizë të këndshme, një tjetër vepër artistike me joshë befasuese. Dhe kjo ndodh vetëm një herë në vit: në panairin vjeshtak të librit.

Tiranë, 25 dhjetor 2018